



QENDRA PËR ZHVILLIM TË RAJONIT PLANOR JUGPERËNDIMOR

RAPORT VJETOR
për punën e Qendrës për zhvillim të RPJP
për vitin 2019

Janar 2020

HYRJE

Aktivitetet e Qendrës për zhvillim të rajonit planor JUGPERËNDIMOR në vitin e kaluar 2019, përgjithësisht, dalin nga statusi i institucionit në pajtim me kornizën normative të përcaktuar, si dhe dokumentet operative – vjetore të miratuara nga Ministria e vetëqeverisjes lokale dhe nëntë komunat – themeluese, që bëjnë pjesë në Rajon. Një nga dokumentet thelbësore, që i përcakton aktivitetet dhe detyrat e Qendrës për zhvillim të RPJP, në vitin vijues është Marrëveshja për bashkëpunim në vitin 2019, nënshkruar mes Ministrisë për vetëqeverisje lokale dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale nga rajoni planor Jugperëndimor.

Qendra për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor në pajtim me detyrimet ligjore, dhe duke i respektuar praktikat e transparencës së punës, e dorëzon këtë Raport Vjetor për punën për vitin 2019.

Më poshtë në Raport janë vendosur informacione për: Realizimin e projekteve të miratuara me Vendimin për shpërndarje të mjeteve për financim të projekteve për zhvillim të rajoneve planore për vitin 2019; Realizimin e projekteve me mjete të siguruar nga burime tjera financimi (bashkësia e donatorëve, ministri dhe organe tjera); Përgatitjen e propozim projekteve për zhvillim të rajoneve planore për vitin 2020; Organizimin e mbledhjeve të Këshillit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor; Pjesëmarrje në aktivitete e Ministrisë për vetëqeverisje lokale në procesin e përgatitjes së akteve nënligjore, informacioneve, raporteve dhe materialeve tjera të përcaktuara me Ligjin për zhvillim të barabartë rajonal; Përgatitjen e Raportit vjetor për realizimin e Programit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor, Raport për punën e Qendrës për vitin 2019; Përgatitjen e Propozim Planit Aksionar për implementimin e Programit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor për vitin 2020; Organizimin e takimeve, punëtorive dhe vizita në terren të ndërlidhura me detyrimet ligjore të Qendrës për zhvillim dhe Aktivitete vijuese të ndërlidhura me funksionimin e Qendrës për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor.

1) Realizimi i projekteve të miratuara me Vendimin për shpërndarje të mjeteve për financim të projekteve për zhvillim të rajoneve planore në vitin 2019

Gjatë vitit 2019 Qendra realizoi tre projekte rajonale të financuara përmes Programit për zhvillim të barabartë rajonal të Ministrisë për vetëqeverisje lokale dhe Byrosë për zhvillim rajonal: 1.Përshtatja e objekteve me EE në RPJP; 2.Rikonstruktimi dhe ndërtimi i rrjetit të ri rrugor; dhe 3.Përgatitja e dokumentacionit teknik për rrugë lokale dhe rajonale. Vlera e përgjithshme e projekteve të realizuara është 41.500.000 denarë, me çka pjesa më e madhe e mjeteve janë të siguruar nga BZHR, ndërsa pjesa tjetër nga komunat-partnere në projekt. Detaje për çdo aktivitet në kuadër të projekteve të theksuara janë dhënë në Raportin vjetor për realizimin e Programit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor për vitin 2019.

2) Realizimi i projekteve me mjete të siguruar nga burime tjera

a) Ministria për vetëqeverisje lokale dhe Agjencia Zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim (SDC), vitin e kaluar, përmes shemës së granateve “Zhvillim i barabartë rajonal i qëndrueshëm dhe inkluziv”, Qendrave për zhvillim të rajoneve planore u mundësoi financimin e projekteve infrastrukturore dhe inovative. Në këtë kontekst në Rajon u realizuan: Projekti infrastrukturor – Rregullimi i zonave atraktive dhe rrugicave në rajon dhe Projekti inovativ – Vizualizimi i atraksioneve turistike në rajonin planor Jugperëndimor. Shuma totale e projekteve të realizuara është 12.283.000 denarë, ku pjesa më e madhe e mjeteve është siguruar nga SDC/MVL në vlerë prej 8.900.000 denarë, ndërsa pjesa tjetër u sigurua nga ana e komunave partnere në projekt. Detaje nga çdo aktivitet në kuadër të projekteve të theksuara janë dhënë në Raportin vjetor për realizimin e Programit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor për vitin 2019.

b) Në kuadër të marrëveshjes së nënshkruar mes Ministrisë për vetëqeverisje lokale dhe Agjencioni Zviceran për zhvillim dhe bashkëpunim (SDC), përmes marrëveshjeve të veçanta për mbështetjen e Qendrave për zhvillim dhe Biznes qendrave, në Strugë u realizua Konferenca ndërkombëtare dy ditore për zhvillim të barabartë rajonal me pjesëmarrje të përfaqësuesve nga institucionet nacionale, rajonale dhe lokale. Si pjesë e aktiviteteve të Biznes qendrës u përgatit baza e të dhënave të subjekteve afariste më të rëndësishme në rajon, u realizua anketim dhe u krye analiza e nevojave për trajnim për biznes sektorin, me qëllim për të përmirësuar konkurrencën në sektorin real. Për realizimin e këtyre aktiviteteve janë harxhuar 560.000 denarë.

c) Vitin e kaluar nga ana e Agjencia për përkrahje financiare të bujqësisë dhe zhvillimit rural u soll Vendim për miratimin e projektit rajonal të Qendrës për zhvillim të RPJP në kuadër të masës “Zhvillimi i infrastrukturës publike në zonat rurale” e cila është pjesë e programit për përmirësimin e kualitetit të jetës në zonat rurale. Gjithashtu, u nënshkrua marrëveshje për realizimin e aktiviteteve në vlerë totale prej 12.620.000 denarë, ndërsa pjesa tjetër – 2.463.690 si pjesëmarrje për mbulimin e TVSH-së që duhet ta mbulojnë komunat partnere. Shumë shpejt pritet të fillojnë aktivitetet në terren.

3) Përgatitja e propozim projekteve për vitin raportues dhe vitin 2020;

a) Vitin e kaluar, pas organizimit të tri forumeve në Rajon, u zhvilluan 5 (pesë) projekt koncepte për Projekte infrastrukturore për aplikim tek Shema e granteve “Zhvillim i barabartë rajonal i qëndrueshëm dhe inkluziv”. Nga ana e Komisionit të MVL u miratua për financim Projekti infrastrukturor – “Rregullimi i zonave dhe rrugëve atraktive dhe projekti inovativ”, i cili u përgatit, dhe plotësisht u realizua në afatin e përcaktuar.

b) Përmes Shemës së granteve “Zhvillim i barabartë rajonal i qëndrueshëm dhe inkluziv”, në vitin raportues, u organizuan dy takime konsultative për zhvillimin e ideve dhe projekt koncepteve për projekte inovative. Me përfshirjen e strukturave të rëndësishme nga rajoni u përgatitën 3 (tre) projekt koncepte, nga të cilat Komisioni i MVL e miratoi për financim projektin Vizuelizimi i atraksioneve turistike në rajonin planor Jugperëndimor.

c) Në thirrjen publike të Ministrisë së bujqësisë, pylltarisë dhe ujërave, për financim të projekteve përmes Programit për subvencione kapitale për zhvillim të rajoneve planore në sferën e bujqësisë dhe zhvillimit rural në vitin 2019, Qendra për zhvillim përgatiti dhe dorëzoi propozim projektin “Përmirësimi i qasjes deri te hapësirat e punueshme në rajonin planor Jugperëndimor”. Partnerë në projekt janë të gjithë nëntë komunat në kuadër të rajonit planor Jugperëndimor. Sipas informacioneve të fundit nga MBPU, për shkak të rebalancit të buxhetit, ky zë i Ministrisë është shkurtuar, dhe nuk janë miratuar aplikacionet e dorëzuara.

d) Qendra për zhvillim të RPJP në pajtueshmëri me praktikat e deritanishme organizoi punëtori planifikuese për gjenerimin e propozim projekteve rajonale për vitin 2020. Punëtorja u organizuar më 12 nëntor 2019 në Strugë, me pjesëmarrje të të gjithë palëve të interesuara – përfaqësues të komunave, biznes sektorit, institucionet arsimore dhe sektorin e OJQ-ve të rajonit Jugperëndimor. U gjeneruan 35 projekt ide të cilat u grupuan sipas qëllimeve strategjike dhe prioriteteve në pajtueshmëri me Programin për zhvillim të RPJP, dhe në bazë të këtij dokumenti u përgatit lista vjetore e propozimeve për vitin 2020.

Lista e propozim projekteve u shqyrtua, u radhit dhe u miratua nga ana e Këshillit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor e cila u mbajt në 14 nëntor 2019. Në bazë të listës vjetore të miratuar për vitin 2020, si dhe në bazë të informacionit të mjeteve të projektuara për ZHBR për vitin 2020, Qendra përgatiti projekte rajonale. Në pajtueshmëri me nenin 34-a, pika 1 nga Ligji për zhvillim të barabartë rajonal, deri tek Byroja për zhvillim rajonal i dorëzoi këto projekte rajonale për vitin 2020:

1. *Përshatja e objekteve me efikasitet energjetik dhe shfrytëzimi i BRE në RPJP, partnerë – Komuna e Strugës, Kërçovës, Ohrit, Debërcës, Dibrës, Qendrës Zhupë dhe Vevçanit*
2. *Dixhitalizimi i dokumentacionin urbanistik-planifikues dhe krijimin e kadastër nëntokësor në RPJP, partnerë të nëntë komunat e Rajonit, dhe*
3. *Projekt rezervë - Përgatitja e dokumentacionit teknik dhe kontrolli energjetik për EE në objekte publike, partnerë të nëntë komunat e Rajonit.*

4) Organizimi i mbledhjeve të Këshillit për zhvillim të RPJP

Deri në fund të vitit 2019 u mbajtën 4 (katër) mbledhje të Këshillit për zhvillim të RPJP. Në mbledhjet u shqyrtuan dhe miratuan: Plani aksionar për vitin 2019, Raporti vjetor për realizimin e Programit për zhvillim për vitin 2018, Raporti vjetor për punën e Qendrës për zhvillim të RPJP në vitin 2018, Raport financiar me llogaritë vjetore për vitin 2018, Lista vjetore me projekte për vitin 2020, Plani financiar për vitin 2020 dhe dokumente tjera në pajtim me detyrimet ligjore dhe kompetencat e Këshillit për zhvillim të RPJP.

5) Azhurnimi i evidencës për potencialet zhvillimore të rajonit planor Jugperëndimor

Pas përgatitjes së bërë, listat evidentuese janë dorëzuar deri te të gjitha komunat në kuadër të rajonit planor Jugperëndimor. Gjithashtu, u organizuan më shumë takime pune në Qendrën për zhvillim, dhe u bënë edhe vizita nëpër komuna. Në bazë të gjithë të dhënave të grumbulluara nga të gjitha komunat e Rajonit u përgatitën Listat evidentuese për secilën komunë veçanërisht, dhe në fund u bë një Listë evidentuese e përbashkët për rajonin planor Jugperëndimor.

6) Pjesëmarrje në aktivitetet e Ministrisë së vetëqeverisjes lokale në procesin e përgatitjes së akteve nënligjore, informacione, raporte dhe materiale tjera të përcaktuara me Ligjin për zhvillim të barabartë rajonal

Gjatë vitit 2019 në të gjitha ftesat për takime pune të dërguara nga ana e Ministrisë për vetëqeverisje lokale, përfaqësues të Qendrës për zhvillim të RPJP morën pjesë aktive. Gjithashtu, të gjitha informacionet dhe materialet e kërkuara janë përgatitur dhe dërguar në afatet e përcaktuara.

7) Përgatitja e Raportit vjetor për realizimin e Programit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor për vitin 2018

Raporti vjetor është i përgatitur në fillim të vitit dhe në të janë vendosur të gjitha aktivitetet që i ka realizuar Qendra për zhvillim gjatë vitit 2018, në pajtim me Planin aksionar. Raporti është i përkthyer në gjuhën shqipe dhe të dy versionet gjuhësore janë dorëzuar deri tek Këshillat Komunal në kuadër të rajonit planor Jugperëndimor. Raporti vjetor për vitin 2018 u shqyrtua dhe miratua nga ana e Këshillit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor.

8) Përgatitja e propozim Planit aksionar për realizimin e Programit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor për vitin 2019

Në fillim të muajit janar të vitit 2019 u përgatit Plani për furnizime publike për vitin 2019, si dhe Plani aksionar. Plani aksionar u shqyrtua dhe miratua nga ana e Këshillit për zhvillim në seancën e mbajtur në mars. Në pajtim me detyrimet ligjore Qendra për zhvillim e përgatiti edhe Planin financiar për vitin 2020 dhe i njëjti u shqyrtua dhe miratua nga ana e Këshillit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor në seancën e nëntë që u mbajt në nëntor të vitit 2019.

9) Aktivitete tjera rrjedhëse

Gjatë periudhës mars-qershor 2019 përfaqësuesit e Qendrës për zhvillim të RPJP morën pjesë në Këshillat e komunave të rajonit Jugperëndimor, në të cilat një nga pikat e rendit të ditës ishin Raporti vjetor për realizimin e Programit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor dhe raportin financiar për vitin 2018. Gjithashtu, u bë një prezantim i shkurtër i raporteve dhe ju përgjigjen pyetjeve të

parashtruara nga ana e këshilltarëve për projektet rajonale në të cilat vet komunitat kanë qenë partnere.

Anëtarët e ekipit të Qendrës për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor gjatë vitit të kaluar morën pjesë në një sërë trajnimesh të organizuara nga ana e ministrive dhe institucioneve të tjera në nivel nacional, si dhe në ngjarje të organizuara nga ana e komunave të Rajonit. Ndër ngjarjet më të rëndësishme në të cilat morën pjesë anëtarët e ekipit të Qendrës për zhvillim për vitin 2019 është takimi në UNDP për angazhimin e operatorit ekonomik për përgatitjen e Studimit të fizibilitetit dhe dokumentacionit teknik për zgjedhjen e problemit me qentë endacak në RPJP. Në takim u prezantuan dhe skenarët e mundshëm për tejkalimin e këtij problemi. Gjatë vitit u organizuan tre takime me grupin e sektorit në MVL ku u miratuan dhe u votua Rregullorja për punë, Plani aksionar dhe indikatorët e projektit “Zhvillim i barabartë rajonal i qëndrueshëm dhe inkluziv”

Përveç aktiviteteve të përmendura më sipër gjatë periudhës janar deri në dhjetor 2018, takime të shpeshta u mbajtën me Komunitat e Rajonit me qëllime të ndryshme, si dhe me anëtarët e grupeve të ekspertëve nga komunitat dhe konsulentët e angazhuar për projektet që u realizuan gjatë vitit kalendarik.

Gjatë periudhës janar - dhjetor 2019, Qendra për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor përgatiti 17 furnizime publike prej të cilave 13 furnizime publike u realizuan në mënyrë të plotë, ndërsa 3 furnizime u publikuan dhe u realizuan për herë të dytë, ndërsa njëra nga furnizimet publike u publikua dhe u realizua pas shpalljes së tret. Nga numri i përgjithshëm – 16 u realizuan si shpallje publike të hapura me procedurë të thjeshtë, ndërsa njëra është realizuar përmes Kërkesës për grumbullimin e ofertave.

16 furnizimet publike të realizuara kanë të bëjnë me implementimin e projekteve rajonale, ndërsa njëri furnizim ka të bëjë me punën vijuese të Qendrës për zhvillim. Vlera e përgjithshme e marrëveshjeve të nënshkruara për të gjitha furnizimet e realizuara është 61.300.000 denarë me gjithë TVSH. Furnizimet në të gjitha fazat u realizuan në formën elektronike përmes Sistemit elektronik për furnizime publike pranë Byrosë për furnizime publike dhe të gjitha përfunduan me ankand elektronik.

Përveç këtyre, në pajtueshmëri me Rregulloren e donatorëve për realizimin e disa aktiviteteve nga projekti “Zhvillim i barabartë rajonal i qëndrueshëm dhe inkluziv”, i financuar nga Agjencioni zviceran për zhvillim dhe bashkëpunim dhe Ministria për vetëqeverisje lokale, u realizuan tre furnizime për organizimin e forumeve rajonale, angazhimin e moderatorit për forume dhe për organizimin e konferencës ndërkombëtare. Vlera e përgjithshme e marrëveshjeve të nënshkruara është 700.000 denarë.

Qendra për zhvillim të
rajonit planor Jugperëndimor